



Lëvrimi i shqipes dhe alfabeti i përbashkët, shprehje e përpjekjeve për bashkimin kombëtar.

Dr. Përparim Fakaj, Msc. Julian Fakaj, Msc. Suela Fakaj

Abstract

The language as the main tool of communication plays an important role in the life of human society. Coexisting in symbiosis with each other they condition their existence and their development. The language is inherent feature of a nation, the symbol of joint, a value and its identity. The patriotic Ideal joined the renaissance in the war and in their attempt for the national independence and for the protection of the values of our beautiful language. This is the reason that the Renaissance writers a century ago, being conscious for the role of the language as a feature of the nation, and also for the conditions in which was the Albanian nation and his language where even his existence was doubtful , they wrote " the Albanian language is done".

As passionate patriots they were, missing so much their country, they appreciated too much the values of our language, the Albanian language, " what a beautiful language we have" Naim Frasheri wrote, " without Albanian language there is no Albanian nation" Sami Frasheri wrote. Apart from that they were conscious that it remained a long way for the Albanian language to become a modern language of the Albanian's culture, so even the issue of the Albanian language joined all the other forms of the war for national independence.

In the beginning of the twentieth century the spread of the Albanian schools and the teaching of the Albanian language, also the development of the national culture in general , gave importance to the need of setting an only alphabet because there were various ones (about 150) which were a snag for a quick development of the Albanian language and writing. the lack of an alphabet was considered by the renaissance representatives as the most immediate task for the time. They didn't it only as a linguistic or cultural problem but even as a political issue which stumbled the joint of the Albanians, because its solution would help in the launch of the Albanian language and literature, and in the consolidation of the national union and the political joint of the Albanian people. Those attempts were crowned in the Manastiri's

Congress in 1908, which legally lectured the alphabet of nowadays , supported by the Latin alphabet, and in the same time was reached the proclamation of Independence and the creation of the independent Albanian state.

Keywords: tillage, alphabet, ideal, patriotic, national unity, program.

Abstrakt

Gjuha si është mjeti më i rëndësishëm i komunikimit luan një rol të veçantë në jetën e shoqërisë njerëzore. Duke bashkëjetuar në simbiozë me njëra-tjetrën, ato kushtëzojnë ekzistencën dhe zhvillimin e tyre. Gjatë gjithë shekujve populli shqiptar e ka parë kurdoherë gjuhën në lidhje me vetëdijen etnike, si tipar i qenësishëm i kombit dhe simbol i përbashkësisë. Prandaj shohim se që nga Gjon Buzuku e këtej është zbatuar një politikë gjuhësore, që është rrënjësor gjithnjë e më thellë në mendjet dhe zemrat e njerëzve.

Problemi i gjuhës shqipe ishte pjesë përbërëse thelbësore e programit politik e kulturor të Rilindjes. Ideali patriotik bashkoi rilindësit në luftën dhe përpjekjet për pavarësinë kombëtare e për ruajtjen e vlerave të gjuhës sonë të bukur. Propagandimin e gjuhës së përbashkët shqipe ata e cilësuan si elementi i parë tregues i kombit. Është kjo arsyeja që rilindësit duke qenë të vetëdijshëm për rolin e gjuhës, si dhe për kushtet në të cilat ndodhej kombi shqiptar dhe gjuha e tij, ku vihej në dyshim ekzistenca e saj, shkruanin se "shqipja u bë". Sipas tyre gjuha e përbashkët do të shpjerë tek masat e gjera popullore idetë e mëdha të Rilindjes, prandaj ata ngritën lart vlerat e gjuhës sonë, të gjuhës shqipe, "gjuha jonë sa e mirë", shkruante Naimi, "pa gjuhë shqipe, s'ka komb shqiptar", thoshte Samiu. Megjithatë ata ishin të vetëdijshëm se mbetej një rrugë e gjatë që shqipja të bëhej një gjuhë moderne e kulturës së shqiptarëve, ndaj dhe çështja e gjuhës amtare bashkohej me të gjitha format e luftës e të lëvizjes për pavarësi kombëtare.

Në fillim të shek. XX përhapja e shkollave dhe e mësimi



të gjuhës shqipe, si edhe zhvillimi i kulturës kombëtare në përgjithësi, shtruan në rend të ditës nevojën e caktimit të një alfabeti të vetëm, sepse ekzistonin një mozaik variantesh (rreth 150 variante dhe nënvariate), të cilët bëheshin pengesë për një zhvillim të shpejtë të gjuhës dhe të shkrimit shqip. Rilindësit mungesën e një alfabeti të njëjtë të gjuhës shqipe e konsideronin detyrën më të ngutshme të kohës. Ata e shihnin atë jo vetëm si një problem thjesht gjuhësor e kulturor, por edhe si një çështje politike, një shenjë ndasie, që pengonte bashkimin e shqiptarëve, pasi zgjidhja e saj do të ndihmonte si në lëvrimin e mëtejshëm të gjuhës e të letërsisë shqipe, ashtu edhe në konsolidimin e unitetit kombëtar dhe të bashkimit politik të popullit shqiptar. Këto përpjekje u kurorëzuan me Kongresin e Manastirit në vitin 1908, i cili ligjëroi alfabetin që kemi sot, mbështetur në atë latin, si dhe me Shpalljen e Pavarësisë e krijimin e shtetit të pavarur shqiptar.

Fjalë kyçe: lëvrim, alfabet, ideal, patriotik, bashkim kombëtar, program.

Gjuha është mjeti më i rëndësishëm i komunikimit që luan një rol të veçantë në jetën e shoqërisë njerëzore. Ato, duke bashkëjetuar në simbiozë me njëra-tjetrën, kushtëzojnë ekzistencën dhe zhvillimin e tyre. Kur bëhet fjalë për gjuhën mendohet në radhë të parë për funksionin e saj shoqëror si mjet kumtimi ndërmjet njerëzve, si një sistem i ndërlikuar shenjash, që u shërben njerëzve për t'u marrë vesh ndërmjet tyre. Si e tillë, atë duhet ta shohim me syrin e ndryshimit, zhvillimit, sepse si çdo gjë në botë edhe gjuha pëson ndryshime. Duke ecur përkrah zhvillimit shoqëror, historia e një gjuhe mund të hedhë dritë mbi historinë e popullit që e flet atë, prandaj ajo shërben edhe si dëshmitare e fateve të tij historike. Kështu që në mungesë të një dokumentimi të hershëm historik, që mund të hidhte dritë mbi të kaluarën e largët të popullit tonë, burimi më i sigurt mbetet vetë gjuha, që ka folur populli ynë brez pas brezi dhe që është njëkohësisht një dëshmitare e sigurt e fateve të tij në rrymë të shekujve.

Dijetari i shquar, albanologu dhe indoevropianisti i madh Norbert Jokli, ka folur për këtë mjet me të cilin mund të ndriçohet deri diku "muzgu i fillimeve të popullit shqiptar" duke hyrë në kohën "tejtë dëshmitare historike". "Këtë mjet, - thotë ai, - na e jep gjuhësia". Gjuha shqipe është mjeti për të zbritur drejt mugëtirave të historisë sonë.

Gjuha e çdo populli shpreh kulturën e tij dhe u jep përdoruesve të saj unitet komunikimi, duke lehtësuar edhe njësinë politike e territoriale. Nëpërmjet gjuhës transmetohet në kohë pasuria e përbashkët kulturore e një populli, ruhen traditat dhe zhvillohet më tej kultura kombëtare, duke i dhënë edhe homogjenitetin e duhur bashkësisë etnike e kombëtare përkatëse. Për këtë arsye

gjuha përbën elementin më të përdorur në identifikimin e popujve e të ndarjes së tyre gjeografike. (1). Gjatë gjithë shekujve populli shqiptar e ka parë kurdoherë gjuhën në lidhje të ngushtë me vetëdijen etnike, si tipar i qenësishëm i kombit dhe simbol i përbashkësisë. Prandaj shohim se që nga Gjon Buzuku e këtej është zbatuar një politikë gjuhësore, që është rrënjësor gjithnjë e më thellë në mendjet dhe zemrat e njerëzve.

Duke e parë gjuhën si tipar të kombit dhe si element të qenësishëm të tij, në këtë artikull do të trajtojmë punën e atdhetarëve shqiptarë në rrjedhë të kohërave për lëvrimin e gjuhës shqipe dhe për alfabetin e përbashkët, përpjekje këto që çuan në bashkimin e kombit shqiptar e Shpalljen e Pavarësisë Kombëtare në vitin 1912.

Dihet se qytetërimi i një populli lidhet ngushtë edhe me traditën shkrimore. Atë e kushtëzojnë shumë faktorë gjuhësorë e jashtëgjuhësorë. Shqipja dhe shqiptarët janë pjesë e Gadishullit Ballkanik, e këtij gadishulli ku jetojnë popuj të ndryshëm, që janë trashëgimtarë kulturash dhe gjuhësh të ndryshme jo vetëm të familjes indoevropiane, por edhe të familjeve të tjera gjuhësore. Prandaj, brenda kësaj hapësire bashkëjetese e fqinjësie historike, në fushën e kulturës materiale e shpirtërore ka edhe ndikime. Megjithatë, shqiptarët kanë trashëguar dhe ruajtur me kohë individualitetin e tyre kulturor dhe gjuhësor.

Duke i hedhur një vështrim traditës së hershme të shkrimeve shqip e të shkrimtarëve shqiptarë, të cilët përkthyen vepra fetare ose shkruan vepra të tilla, siç ishte "Meshari" i Gjon Buzukut, del qartë veprimtaria e tyre në favor të shqipes, kundër politikës shkombëtarizuese të pushtuesit osman. Vepra e Gjon Buzukut ka një rëndësi të veçantë për historinë e shkrimit e të letërsisë shqipe. Ajo na bën të njohur me një nga përpjekjet e para më të rëndësishme të lëvrimin të shqipes si gjuhë e shkruar në një periudhë shumë të rëndë të historisë së popullit tonë dhe njëkohësisht na jep një material të pasur për studimin e shqipes së shekullit XVI, të historisë së brendshme të gjuhës sonë dhe të historisë së gjuhës së shkruar. Në shekujt XVI-XVII, siç del në veprat e autorëve të vjetër (të Gjon Buzukut, të Pjetër Budit, të Frang Bardhit, të Pjetër Bogdanit, të Lekë Matrëngës, të Gjon Kazazit etj.), gjuha shqipe paraqitet në përgjithësi e përpunuar dhe e pasur. Synimi i tërë veprimtarisë së tyre ka qenë të hidhnin në fjalorë tërë pasurinë leksikore e frazeologjike të shqipes, "për të nxjerrë në dritë fjalë plaka e të harrueme, - siç thoshte P. Bogdani, - që gjuha jonë të mos bdarret e bastardhohet."

Kjo lidhje ngushtë me luftën që bëhej për gjuhën amtare e kulturën kombëtare, me ruajtjen e vetëqenies së gjuhës, me forcimin e karakterit kombëtar nëpërmjet pasurimit të shqipes me fjalë të brumit të vet, sidomos nga burimet popullore, dhe me pastrimin nga lënda e huaj e panevojshme. Kjo shihet qartë edhe në një letër që Sami Frashëri i shkruan De Radës gjatë Rilindjes, ku ndër të tjera i shkruan se "ca nga frazet dhe nga fjalët



e gjuhës janë humburë, me ca anë të Shqipërisë e të kolonivet e janë rojtur në ca anë të tjera; me të për mbledhurë të gjithë këtyre fjalëve e fraseve bashkë, edhe gjuha shqipe do të bëhetë e begatë e e gjerë, e do të shpetonjë nga të pasurit nevojë me fjalë të huaja, edhe gjithë dialektatë do të gjendenë të gjitha të bashkuara e të përzjera.”(2)

Duke e krahasuar shqipen me gjuhët e tjera si dhe duke i bërë një prerje diakronike historisë së saj, mbështetur në kontekstin historik të kohës dhe të dhënat e albanologëve të huaj, shqipja hyn në radhën e atyre gjuhëve indoevropiane, që për arsye të ndryshme kanë nisur të lëvrohen vonë me shkrim. Gjuhë të tilla kanë qenë rumanishtja në Ballkan dhe lituanishtja jashtë Ballkanit, sepse teksti më i vjetër i lituanishtes, është ai i vitit 1547. (3). Meshari i Gjon Buzukut konsiderohet vepra e parë monumentale e shqipes së shkruar. Si shkaqe kryesore që penguan shkrimin e hershëm dhe diktuan këtë gjendje të shqipes përmendim: pushtimet e gjata nga shtetet e huaja, të cilat penguan formimin e hershëm të një shteti të bashkuar shqiptar si dhe përdorimi si gjuhë të administratës së tyre një nga gjuhët ekspansive të kohërave (si greqishtja dhe latinishtja, sllavishtja, të cilat ishin dhe gjuhë të kulturës në vende të ndryshme).

Patriarku i gjuhës shqipe, prof. E. Çabej, duke vlerësuar shkrimin shqip të “Meshari” i Gjon Buzukut (1555) pohon njëkohësisht, se para tij duhet të ketë pasur libra në shqip. Vetë gjuha e Mesharit tregon se “ajo nuk është një arë e papunuar më parë, se në Shqipëri, që në mesjetën e vonë, ka qenë formuar një traditë letrare me shkrime liturgjike, me një ortografi gjer diku të caktuar”. (4). Këtë pohim të prof. Çabejt e vërtetojnë dokumentet e para të gjuhës shqipe, si: “Formula e pagëzimit” e Pal Ëngjëllit, “Fjalorthi” i Arnold fon Horfit (1497) dhe “Perikopeja e Ungjillit të pashkëve” (shek. XV), si dhe dokumentet e tjera zbuluar kohët e fundit, të cilat flasin në mbështetje të mendimit të Çabejt për hershmërinë e shkrimit të shqipes. .

Që shqipja është shkruar para shek. XVI këtë e vërteton në një aspekt edhe alfabeti i Buzukut, që paraqitet mjaft i stabilizuar, që pati jehonë dhe u bë tradicional me disa ndryshime e plotësime, si dhe vetë botimi i veprës së Buzukut dhe dokumente të tjera shkrimore, pasi nuk mund të mendohet botimi i një vepre të gjerë si ajo e Buzukut me një gjuhë të përpunuar dhe me një drejtshkrim pak a shumë të stabilizuar mirë pa njëfarë tradite shkrimi të mëparshme. Stabilizimi i një alfabeti për shkrimin e një gjuhe të palëvruar më parë nuk është punë që bëhet brenda një kohe të shkurtër. Në dobi të hershmërisë së shkrimit shqip flet dhe një fakt drejtshkrimor, ku si te Buzuku dhe te autorët e tjerë verior zanoret e gjata i dallojnë nga të shkurtrat duke ua dyzuar shkronjat përkatëse. Vazhdimësinë e kësaj norme drejtshkrimore e gjejmë te autorët e mëvonshëm, si te Anonimi i Elbasanit, te autorët shkodranë të shek. XIX dhe arbëreshët pas Matrëngës. Gjithë këto fakte flasin

për një traditë shkrimore më të hershme. Mendime të tjera për moshën e shkrimit shqip përmendim Faik Konicën, i cili moshën e shkrimit shqip e shtyn edhe më në thellësi të kohërave. Duke vlerësuar dëshminë e murgut gjerman Brokardi (Brocardos Teutonicus) të vitit 1332 se: “Shqiptarët, ndonëse kanë një gjuhë krejtësisht tjetër nga latinët, në librat e tyre përdorin alfabetin latin”, Konica parashton se kishte shkrime shqipe para këtij viti. Shfaqjen e tyre ai e lidh me shpalljen e Charl Anzhuit mbret të Shqipërisë më 1272, ku shqipja si gjuhë popullore shkruhej thjesht për të lehtësuar veprimtaritë shtetërore. Duke përkrahur mendimin e Milan Shuflajit se në këtë kohë Shqipëria ishte më tepër një zgjatje, vazhdim kulturor e tregtar i Italisë, sesa një rajon nën ndikimin bizantin, Konica mendon se shkrimi shqip është shfaqur aty nga fundi i shekullit XII, kur edhe italishtja popullore po i zinte vendin latinishtes.

Pas botimit të Mesharit, si vepra e parë e plotë në gjuhën shqipe, botimi i fjalorit latinisht – shqip(1635) të Frang Bardhit konsiderohet si “përpyekja e parë e rëndësishme për të hartuar një vepër që në përgjithësi i kapërcen synimet e një vepre thjesht fetare, sepse Bardhi në fund të fjalorit ka renditur edhe shtatë kapituj të shkurtër për numërorët themelorë e rreshtorë, për emrat farefisnorë, disa emra vendesh, ndajfolje, parafjalë, pasthirrma dhe një varg proverbash në gjuhën shqipe”. (5).

Për këtë veprimtari botuese në gjuhën shqipe merren në konsideratë thëniet e vetë autorëve të veriut, e këtyre dijetarëve e atdhetarëve të mëdhenj që njihen si Katër B-të e Veriut: Buzuku Budi, Bogdani e Bardhi, për motivet që i shtyn të hartonin veprat e tyre. Ata vetë pohojnë se i vetmi motiv ka qenë dashuria për gjuhën e për popullin e tyre që vuanin si nga pushtimi i huaj, ashtu edhe nga pesha e rëndë e paditurisë. Sepse kishin përmbajtje fetare, prandaj lejohej botimi i tyre, por libra si vepra e Bogdanit kishte edhe elemente nga dituritë e kohës, si dhe elemente nga historia e popullit shqiptar, elemente të kulturës popullore, këshilla e porosi për të mënjeluar zakonet e vjetra e të këqija, grindjet, përçarjet, shprehjet e hapura të urrejtjes kundër pushtuesve turq, ankesa për mungesën e shkollave për arsimimin e popullit.

Kjo lëvizje kulturore është ndikim i drejtpërdrejt i ideve të Rilindjes evropiane, që ndihmoi në lëvrimin e pasurimin e mëtejshëm të shqipes e për të shkruar në një koine të dialektit verior. Si rezultat i këtij zhvillimi të shqipes, i stadi që ajo arriti, si dhe botimit të shkrimeve e veprave të para shqipe u përgatitën kushtet për çeljen e shkollave të para shqip në Veri dhe në Jug të vendit, qysh në shek. XVI-XVII.

Këto shkolla janë pionieret e para të arsimit e të shkollës shqipe. Ato krijuan kushtet e përshtatshme për çeljen e shkollave të para në Veri dhe në Jug të vendit me të cilat fillon dhe historia e arsimit në gjuhën shqipe. Tashmë ekzistenca e këtyre shkollave të hershme në viset veriore është një e vërtetë e pamohueshme dhe e dokumentuar. Sipas një studimi të Atë Donat Kurtit, botuar në vitin 1935



te "Hylli i Dritës", shkollat në këto vise janë çelur që në vitin 1638. Ai përmend tri shkolla: shkollën e Pllanës, e Blinishtit dhe të Shkodrës". Kurse studiuesi amerikan Edvin Zhak në veprën e tij "Historia e popullit shqiptar nga lashtësia deri në ditët e sotme" i çon shkollat e para shqipe pak më përpara në kohë, në vitin 1632, kur sipas tij është hapur shkolla e Velës në Mirditë. Sipas tij, kjo nuk ishte e vetmja pasi një shkollë tjetër mjaft e hershme ishte hapur në Kurbin më 1632. Përveç shkrimit e leximit aty mësohej gramatika shqipe dhe përdorshin librat e Bardhit, Budit e Bogdanit". Gjithashtu ky studiues përmend edhe shkollat e tjera të hapura në Pllanë, një fshat afër lumit Mat, më 1638, në Troshan, më 1639, dhe në vetë qytetin e Shkodrës, më 1698". Më pas u çelën shumë shkolla të tjera ku sipas tij deri më 1878, në qytetet veriore shqiptare e deri në Durrës kishte 21 shkolla të tjera fillore shqipe, që zhvillonin veprimtarinë e tyre. Ai sqaron se secila prej këtyre shkollave kishte rreth tridhjetë nxënës, përveç asaj të Prizrenit, e cila kishte tetëdhjetë nxënës.

Por, siç vërtetohet nga dokumente të ndryshme, shkolla shqipe të kësaj kohe me shkollat e Veriut të vendit ka pasur edhe në Jug. Duke iu referuar "Fjalorit enciklopedik shqiptar" (2008) shohim se shkolla ku mësohej shqipja ka pasur në Himarë më 1627, në Vuno (fshat shqipfolës) e Palasë më 1632 dhe në Dhërmi më 1660. (6).

Po kështu edhe studiuesi himarjot Aleko Rrapo thotë se "misionarët bazilianë hapën më 1627 një shkollë në Himarë dhe më pas në fshatra të tjera të Bregut e në thellësi dhe se në to mësohej shkrim e këndim në gjuhën shqipe, duke përdorur si tekst mësimor "Doktrinën e krishterë" të Budit". (7).

Me ndërprerje të shkurtra për shkak të ekspeditave ndëshkimore turke ndaj krahinës, shkollat e Himarës ku mësohej shqipja u mbajtën hapur deri më 1741. Ato i ndoqën fëmijë nga Tragjasi, Tërbaçi, Kuçi dhe fshatra të tjera të Labërisë, madje edhe nga familje myslimane.

Siç pohon prof. Rami Memushaj në studimin e tij "Himara në shekuj" se përpara, krahas apo pak më pas shkollës së Kurbinut, shkolla shqipe ka pasur edhe në Himarë. Për këtë ai shfrytëzon edhe të dhënat që jep libri në dy vëllime i Nilo Borxhës "I monaci basiliani d'Italia in Albania" (vëll. I 1935, vëll. II 1942). Dihet se krahina e Himarës që një nga tri krahinat e vetëqeverisura të Shqipërisë, ku pushtuesi osman mundi ta vendoste administratën e vet vetëm pas shtypjes së kryengritjes së Tanzimatit.

Kryengritjet e mëdha në këtë krahinë zgjatën një shekull të tërë (ato të viteve 1432, 1481, 1492 dhe 1537), të cilat bënë të dështonin planet e sulltanëve për pushtimin e Italisë dhe që tërhoqën vëmendjen e Selisë së Shenjtë, e cila dërgoi në Himarë një mision murgjish bazilianë, që e filloi veprimtarinë e vet aty nga viti 1581 e vijoi deri në vitin 1741, kur nga presioni turk dhe i fanarjotëve, misionarëve italianë iu bë i pamundur qëndrimi i mëtejshëm në krahinë. Siç del nga relacionet e kohës të pasqyruar në librin e Nilo Borxhës, misionarët murgj

bazilianë qëndruan në Himarë dhe zhvilluan veprimtarinë e tyre nga viti 1581 e deri në vitin 1741, e bashkëpunuan ngushtë me klerikët shqiptarë të Himarës, në luftë me klerikët grek të Korfuzit e të Janinës, që punonin ethshëm për greqizimin e krahinës. Veprimtaria e tyre është pasqyruar në relacionet për Propaganda Fide-n dhe për gjendjen e krahinës së Himarës, që shtrihej nga Kudhës-Grehoti e deri në Delvinë, si dhe për punën e tyre për përhapjen e katolicizmit dhe nxjerrjen nga injoranca të popullsisë së krahinës. Nga pohimet del se në Himarë ka pasur shkollë të paktën që nga vitet 1630 dhe se qiprioti Neofit Rodine, që qëndroi në Himarë gjatë viteve 1633-1642 "ishte pandërprerë mes malësorëve të tij të dashur i preokupuar me evangjelizmin e tyre. . . , dhe me edukimin e fëmijëve të tyre". Rodinoi mbante afër një prift vendas, i cili e zotëronte në mënyrë të shkëlqyer gjuhën shqipe, sepse ishte i kësaj kombësie dhe një katolik i vërtetë. Këtij prifti Rodinoja i ngarkoi detyrën delikate të përkthimit në gjuhën shqipe të Katekizmit", por nga Roma i erdhi përgjigja se "doktrina e krishterë ishte përkthyer dhe botuar në gjuhën shqipe". Më tepër mësojmë edhe nga relacioni që sekretari i Kongregacionit të Shenjtë të Propaganda Fide-s u paraqet kardinalëve, në të cilin shtrohet nevoja "për të dërguar një mësues që t'u mësojë fëmijëve të tyre (të himarjotëve) Doktrinën e Krishterë dhe t'u çojë dritën e së vërtetës".

Informacion tjetër me interes jep edhe misionari arbëresh Xhuzepe Skiro, në një relacion të botuar në vitin 1729 ku ndër të tjera shprehet se "puna e misionarëve u prit me të vërtetë mirë dhe kjo shpjegon vërshimin e nxënësve, që u vinin të numërt, madje edhe nga manastret. Qëndrimi i popullsisë arrinte deri në atë pikë sa t'i lejonte misionarët t'i mësonin doktrinën e krishterë, duke i bërë që ta përsëritnin përmendsh në formë dialogu në sheshet publike në gjuhën greke dhe në gjuhën shqipe; dhe në këtë mënyrë stërviteshin edhe të rriturit, që, të shtyrë nga kurioziteti, vinin të dëgjonin ushtrimin e shenjtë, sidomos të afërmit dhe prindërit e fëmijëve". (II, f. 140).

Prof. Jup Kastrati në veprën e tij "Historia e Albanologjisë", përmend edhe shkollën e Janievës (Kosovë) 1671, ndërsa akademik Shaban Demiraj mendon se në Kosovë tradita e shkrimit shqip është e "vjetër". Këtë mendim ai e mbështet në gramatikën latinisht – shqip të Andrea Bogdanit, ungjit të Pjetër Bogdanit, dorëshkrimi i së cilës i humbi këtij të fundit gjatë njërit prej udhëtimeve të vështira, si dhe me pohimin që bën Pjetër Budi në parathënien e veprës së tij të parë lidhur me shkrimet e një farë Pali prej Hasi. Megjithatë ky zhvillim i këtyre shekujve nuk u pasua në shekujt e mëvonshëm me atë ritëm. Po të ndjekësh veprimtarinë botuese në shek. XVIII në Veri, vihet re një pakësim i saj, sepse gjatë tërë atij shekulli u botua vetëm libri i Gjon Nikollë Kazazit, ndërsa në Shqipërinë e Mesme dhe Jugore bie në sy përpjekjet e para për shkrimin e gjuhës amtare. Kjo gjë vihet re sidomos në qytetet, të cilët në shek. XVIII patën njëfarë zhvillimi ekonomik dhe kulturor, si : *Elbasani, Voskopoja, Berati etj.* , ku



zhvilluan krijimtarinë dy grupe shkrimtarësh duke filluar nga Anonimi i Elbasanit, Dhaskal Todri, Daniel Haxhiu, që shkruan me alfabetet e ndryshme e deri te shkrimtarët që përdorën alfabetin arab, si: Nezim Frakulla, Hasan Zyko Kamberi etj.

Pas traditës treshekullore qysh nga vepra e Buzukut, lëvrimi i shqipes mori një hov të madh gjatë shek. XIX, sidomos në gjysmën e dytë dhe në fillim të shek. XX. Problemi i gjuhës shqipe ishte pjesë përbërëse thelbësore e programit politik e kulturor të Rilindjes. Qysh nga Rilindja Kombëtare mund të flitet për një politikë gjuhësore me synime të qarta kombëtare e shoqërore përparimtare. Ideali patriotik bashkoi rilindësit në luftën dhe përpjekjet për pavarësinë kombëtare e për ruajtjen e vlerave të gjuhës sonë të bukur. Propagandimin e gjuhës së përbashkët shqipe ata e cilësuan si elementin e parë tregues të kombit. Është kjo arsyeja që rilindësit duke qenë të vetëdijshëm për rolin e gjuhës, si dhe për kushtet në të cilat ndodhej kombi shqiptar dhe gjuha e tij, ku vihej në dyshim ekzistenca e saj, shkruanin se *"shqipja u bë"*. Sipas tyre gjuha e përbashkët do të shpjerë tek masat e gjera popullore idetë e mëdha të Rilindjes, prandaj ata ngritën lart vlerat e gjuhës sonë, të gjuhës shqipe, *"gjuha jonë sa e mirë"*, shkruante Naimi, *"pa gjuhë shqipe, s'ka shkollë shqipe, s'ka komb shqiptar"*, thoshte Samiu. Megjithatë ata ishin të vetëdijshëm se mbetej një rrugë e gjatë që shqipja të bëhej një gjuhë moderne e kulturës së shqiptarëve, ndaj dhe çështja e gjuhës amtare bashkohej me të gjitha format e luftës e të lëvizjes për pavarësi kombëtare. Por, kjo politikë gjuhësore, në kushtet kur ende nuk kishim një shtet të pavarur shqiptar, nuk mund të gjente zbatim në veprimtarinë rregulluese të shtetit kombëtar.

Thënia e gjermanit te madh G. Lajbnic: *"Më jepni një gjuhë të bukur, t'ju jap një qytetërim të mbaruar"*, i vinte përpara përgjegjësisë gjuhëtarët shqiptarë për ta vënë njohjen dhe studimin e shqipes mbi baza shkencore. *"Në këtë punë gjigante, - shkruan Jorgo Bullo, - të frymëzuar nga njohja për gjuhën dhe nga patosi i kërkimit shkencor, kanë pjesën e tyre leksikografët, këta qëmtues e "gardianë" të fjalës, që ngulitin fytyrën dhe jetën e saj në veprat e tyre, duke u shërbyer me të përdoruesve të gjerë të gjuhës dhe mjeshtërve të saj, atyre që i japin shpirt e jetë të re fjalës, dhe me anën e saj "i bëjnë të pamundur të mundura", siç pat thënë njëri prej këtyre mjeshtërve, M. Kuteli". (8).*

Në fillim të shek. XX përhapja e shkollave dhe e mësimi të gjuhës shqipe, si edhe zhvillimi i kulturës kombëtare në përgjithësi, shtruan në rend të ditës nevojën e caktimit të një alfabeti të vetëm, sepse ekzistonin një mozaik variantesh (rreth 150 variante dhe nënvariate), të cilët bëheshin pengesë për një zhvillim të shpejtë të gjuhës dhe të shkrimit shqip. Në asnjë nga alfabetet e gjuhëve të Gadishullit Ballkanik nuk u hartuan aq alfabetet sa në shqipe. Ky mozaik variantesh nuk pasqyronte strukturën fonetike të shqipes. Përdorimi i shumë varianteve nuk

ishte diçka e favorshme për kulturën tonë, pasi u bë pengesë për një zhvillim të shpejtë të gjuhës dhe të shkrimit shqip. Vendimi i atdhetarëve shqiptarë për të krijuar një alfabet të përbashkët, që njihet me emrin "alfabeti i Stambollit" (1879), buronte nga nevoja për unifikimin e alfabetit. Megjithëse nuk mundi të përhapej gjithandej e të bëhej alfabeti i vetëm për shkrimin e gjuhës shqipe, sepse në Shqipërinë e Veriut përdoreshin alfabetet e tjerë, si ai i shoqërisë "Bashkimi" dhe i shoqërisë "Agimi" më 1901, hartimi i alfabetit të Stambollit zgjidhi përfundimisht raportin tingull – shkronjë, duke i dhënë fund atij pështjellimi që ekzistonte deri në atë kohë, kur numri i shkronjave për shqipen shpesh i kalonte caqet e tinguj-fonemave të gjuhës sonë, rrjedhojë e mosnjohjes sa duhet të strukturës fonetike të shqipes.

Rilindësit mungesën e një alfabeti të njëjtë të gjuhës shqipe e konsideronin detyrën më të ngutshme të kohës. Ata e shihnin atë jo vetëm si një problem thjesht gjuhësor e kulturor, por edhe si një çështje politike, një shenjë ndasie, që pengonte bashkimin e shqiptarëve, pasi zgjidhja e saj do të ndihmonte si në lëvrimin e mëtejshëm të gjuhës e të letërsisë shqipe, ashtu edhe në konsolidimin e unitetit kombëtar dhe të bashkimit politik të popullit shqiptar dhe vetë zhvillimi i lëvizjes kombëtare në përgjithësi. Për ta mbushur këtë kërkesë atdhetarët shqiptarë shpejtuan të shfrytëzonin gjendjen e krijuar pas shpalljes së Kushtetutës në Perandorinë Osmane (23. 07. 1908). Menjëherë pas kësaj, klubi "Bashkimi" i Manastirit u bë nismëtar për thirrjen e një Kongresi kombëtar, që ka hyrë në histori si Kongresi i Manastirit, i cili ligjëroi alfabetin që kemi sot, mbështetur në atë latin, megjithëse la në përdorim edhe alfabetin e Stambollit. Me këtë vendim iu dha fund kaosit që mbretëronte deri atëherë në çështjen e shkrimit të shqipes. Në vend të alfabeve të shumta që ishin përhapur në Shqipëri e në kolonitë e mërgimit, tani do të përdoreshin vetëm dy, edhe këta bashkërisht. Përveç kësaj, duke vendosur për dy alfabetet, që mbështeteshin në atë latin, Kongresi i Manastirit ripohoi edhe njëherë vendosmërinë e shqiptarëve për të mbrojtur individualitetin e tyre kombëtar, kundër orvatjeve të xhonturqve për t'u imponuar alfabetin arab dhe për t'i identifikuar ata me turqit. Dhe kështu kultura shqiptare sanksionoi përfundimisht emancipimin kulturor drejt Evropës së qytetëruar, u bë faktor i rëndësishëm i individualitetit kulturor.

Pjesë përbërëse e kërkesës për njohjen e kombësisë shqiptare dhe e të drejtave të saj, ishte edhe themelimi i shkollës së pavarur shqipe, që do të arrihej duke i kthyer të gjitha shkollat shtetërore turke në Shqipëri, ato fillore, qytetëse e të mesme, në shkolla kombëtare dhe duke vendosur gjuhën amtare shqipe *"si gjuhë mësimi në të gjitha këto shkolla shtetërore"*, ndërsa turqishtja do të mësohej si lëndë e veçantë, duke filluar nga viti katërt i shkollës fillore. Të lidhura ngushtë me këtë ishin edhe masat që parashikohej të merreshin për kthimin e shkollave në gjuhën greke, që funksiononin për



shqiptarët e krishterë, në shkolla kombëtare, me gjuhën shqipe si gjuhë mësimi, duke i hequr ato nga administrimi i klerit dhe duke i shpallur shkolla shtetërore. Këto shkolla do të mbaheshin me të ardhurat nga pasuritë e kishave, të cilat duhej të administroheshin nga shteti dhe me të ardhurat e buxhetit të shtetit osman. Për t'u prerë rrugën ndërhyrjeve të Austrisë, të Italisë e të Greqisë në Shqipëri, kërkoheshin që klerikët katolikë e ortodoksë të paguheshin nga shteti turk. Me këto masa do të kufizohej ndikimi i propagandave të huaja shkollore e kishtare në Shqipëri, sidomos i asaj greke.

Shkolla kombëtare që kërkonin rilindësit e që kishte për qëllim arsimimin në gjuhën shqipe, duhej të ishte laike, të bëhej një vatër kulture, që të plotësonte nevojat e zhvillimit ekonomik e shoqëror të vendit dhe, njëherazi, një vatër e atdhetarisë dhe e bashkimit kombëtar të shqiptarëve. Rrjedhimisht, kërkesat për shkollën dhe për letërsinë shqipe nuk kishin karakter thjesht kulturor. Iluminizmi shqiptar kishte edhe një karakter politik, u bë armë e fuqishme e luftës çlirimtare. Fryma patriotike u ndie edhe në letërsinë artistike, duke i dhënë asaj një angazhim më të madh e më të drejtpërdrejtë në lëvizjet e mëdha politike të kohës, në luftën për çlirimin kombëtar. Duke përhapur në popull arsimin dhe përgjithësisht kulturën në gjuhën shqipe e me frymë atdhetare, rilindësit synonin të shpejtonin zgjimin e tij kombëtar, të ndihmonin në ngritjen e mëtejshme të ndërgjegjes politike dhe të arrinin aftësimin e shqiptarëve për një jetë shtetërore të pavarur. Kjo lëvizje u bë pjesë e pandarë e luftës për çlirimin kombëtar dhe pati dëshmorët e saj. Me

këtë mision të shkollës e të kulturës shqiptare shpjegohet edhe lufta që u bënë atyre dhe atdhetarëve rilindës Porta e Lartë, Patrikana greke e qarqet shoviniste të shteteve fqinje, të cilat shihnin tek ato një pengesë të fortë për politikën dhe për planet e tyre aneksioniste ndaj trojeve shqiptare.

Përppjekjet e patriotëve shqiptarë për çështjen kombëtare e gjuhën shqipe sollën rezultatin e dëshiruar me Shpalljen e Pavarësisë Kombëtare dhe krijimin e shtetit të ri shqiptar, i cili çështjen e gjuhës do ta kishte në qendër të veprimtarisë së tij duke hartuar një politikë gjuhësore kombëtare të drejtë e që i shërbeu zhvillimit dhe pasurimit të mëtejshëm gjuhës sonë.

Si përfundim mund të themi se gjithë përppjekjet shekullore të atdhetarëve e mësuesve për lëvrimin e shqipes e alfabetin e përbashkët i kanë shërbyer çështjes kombëtare për të mbrojtur vetëqenien, lirinë dhe dinjitetin kombëtar e për të mbajtur gjallë dashurinë për atdheun dhe gjuhën amtare. Ato krijuan kushtet e përshtatshme për çeljen e shkollave të para në Veri dhe në Jug të vendit me të cilat fillon dhe historia e arsimit në gjuhën shqipe. Ideali patriotik i bashkoi rilindësit në luftën dhe përppjekjet për pavarësinë kombëtare e për ruajtjen e vlerave të gjuhës sonë të bukur, sepse, - siç thotë akademik Idriz Ajeti, - *gjuha letrare s'është vetëm thesar i kulturës sonë, por edhe mjet i fortë për mbrojtjen e etnisë sonë*"(9), apo siç thotë patriarku i gjuhës shqipe, prof. E. Çabej *"gjuha është sendi më i çmuar në një popull dhe për popullin shqiptar është i vetmi thesar!"*(10).

Referime bibliografike

Shkurtaj, Gj. , *Shqipja e sotme*, Tiranë, 2010, f. 182

Frashëri, S, *Leter J. De Radës*, Stamboll 20. 02. 1881(cituar sipas Dhimiter Shuteriqit, Mbi gjuhën letrare kombëtare shqipe, BShSh, 1952, IV. f. 54

Demiraj, Sh. , *Gjuha shqipe dhe historia e saj* , Tiranë, 1988

Meshari i Gjon Buzukut (1555), Rilindja, Prishtinë, (1987), (Tiranë, 1968)

Çeliku, M. , *"Fjalor i shqipes së sotme", 2002 dhe leksikografia shqiptare e ditëve tona*" në Seminar Ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare", 22\1, Prishtinë, 2004, f. 214.

Fjalori enciklopedik shqiptar, Tiranë, 2008, vëll. I, f. 116

Buletin i UT, SSHSH, 1963, 3, f. 169–177

Leksikografia shqipe-trashëgimni e perspektivë, Tiranë, 2005, f. 9.

Kryeziu, B. , *Standardi i shqipes dhe disa probleme rreth tij*, në "Seminarin Ndërkombëtar të Albanologjisë" , Ohër, 2007, f. 93 10. Çabej, E. , *Tekstet e vjetra shqip dhe disa kritere rreth botimit të tyre*, në Studime gjuhësore, VI, Prishtinë, 1977, f. 329